



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

**SHPLLJE PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT TË HAPUR
PËR NËPUNËS CIVIL
KATEGORIA E LARTË DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 32, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut të VIII të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.118, datë 05/03/2014, i ndryshuar, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) shpall procedurën e konkurimit të hapur të **Pranimit në Kategorinë e Lartë Drejtuese** për pozicionin:

- Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Trajtimin të Kërkesave.
- Kategoria e pagës I-4.

Afati për dorëzimin e dokumentave:

23.04.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Ndhmon dhe mbikqyr krijimin dhe zbatimin e sistemeve, procedurave dhe rregullave të qarta dhe të sigurta për organizimin, funksionimin, kordinimin, e punës ndërmjet Drejtorisë së Informacionit, Drejtorisë së Verifikimit të Figurave, Drejtorisë të Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar .
- Ndhmon dhe mbikqyr zbatimin e sistemeve, procedurave dhe rregullave të krijuara në lidhje me grumbullimin, klasfikimin e llojit të kerkesave të ndryshme sipas objektit dhe qëllimit, shpërndarjes së tyre sipas funksioneve të drejtoritve përkatëse me qëllimin perfundimtar shqyrtimin dhe kthimin e përgjigjeve përkatëse në lidhje me:

- informimin e qytetarëve, palëve të prekuar, të treta, bashkëpunëtorëve, të favorizuarëve dhe kerkesave të qytetarëve, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimit të tyre tek kërkuesi brenda një afati të arsyeshëm;
- njohjen dhe informimin e qytetarëve në lidhje me shërbimet rehabilituese;
- verifikimin e figurave;
- informimin për personat që konsiderohen të zhdukur;
- informimin e mediave;
- kërkesat për qëllime studimore;
- vënien në dispozicion të autoriteteve shtetërore përkatëse të çdo informacioni të siguruar gjatë veprimtarisë së Autoritetit, kur kjo kërkohet për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale;
- ndalimin përkohësisht të përdorimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kur prokuroria ose gjykata përcakton se nga përdorimi i tyre mund të dëmtohet veprimtaria hetimore, ndjekja penale, ecuria ose përfundimi i një procedimi penal të regjistruar si edhe kur gjykon se përdorimi i tyre mund të përbëjë rrezik real për sigurinë kombëtare;
- konstatimit të përparësisë, prioriteteve për nevojën urgjente të dhënies të një informacioni të caktuar dhe vënien e menjëhershme në dijeni të Drejtorisë së Arkivit se kërkesa është në kushte përparësie.
- Në zbatim dhe përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregullores të brendshme, ndihmon, koordinon, krijimin zbatimin sistemeve, procedurave dhe rregulla të qarta dhe të sigurt në lidhje me aktivitetin e Drejtorive përsa i përket:
 - mbrojtjes të të dhënave të evidentuara gjatë aktivitetit të Drejtorive që mund të përbëjnë apo mund të klasifikohen si sekret shtetëror;
 - mbrojtjes të të dhënave personale të evidentuara gjatë aktivitetit të Drejtorive;
 - mardhënjeve dhe informimin e medias të shkruar, elektronike apo audio vizuale;
 - materialeve që do të shyrtohen për qëllime studimore apo shkencore.
 - Në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive identifikon, harton, i propozon anëtarëve të Autoritetit sisteme, procedura, rregulla të reja të qarta dhe të sigurt për të përmirësuar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Trajtimit të Kerkesave në procesin e informimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës dhe rregullores të brendshme;
 - Koordinon veprimtarinë e drejtorive të ndryshme në lidhje me përgatitjen e materialeve të nevojshme, në përputhje me llojin e kërkesave, që duhen paraqitur për vendimmarrje në mbeldhjet e Autoritetit;
 - Në rastet kur lind nevoja koordinon veprimtarinë e drejtorive përkatëse dhe udhëheq, mbrojtjen dhe përfaqësimin e Autoritetit në procese administrative apo gjyqësore;
 - Kryen detyra të tjera sipas kërkesave të eprorëve.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtit nivel (kategoria I, e lartë drejtuese), ose të njëjti nivel më të ulët (kategoria II, e mesme drejtuese);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të kenë mbaruar arsimin e lartë dhe zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e Shkencave Ekonomike ose Juridike ose të barazvlefshme me to (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b- Të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë pune në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura;
- c- Të kenë eksperiencë si nëpunës civil në nivelin e mesëm drejtues jo më pak se 5 vjet;
- d- Të kenë kualifikime në fushën e Shkencave Administrative;
- e- Të zotërojnë gjuhën angleze (provuar me dokumentet përkatëse). Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
- f- Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;
- g- Nuk është anëtar në parti politike;
- h- Në periudhën 29.11.1944, deri në datën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 02.07.1991, nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i Degëve të Punëve të Brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme;
- i- Nuk ka konflikt interesi me detyrën;
- j- Plotëson kushtet, kriteret për pajisjen me certifikate sigurie, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime/jeteshkrimi-standard/>
Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- c- Fotokopje të diplomave të arsimimit (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (jo më të vjetër se 1 muaj);
- f- Dëshmi penaliteti (jo më të vjetër se 1 muaj);
- g- Deklaratë personale që nuk ka qenë anëtar i një partie politike në 3 (tre) vitet e fundit;
- h- Vërtetim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që nuk ka kandiduar në zgjedhje të përgjithshme apo vendore nën siglën e një partie politike në zgjedhjet që përfshijnë periudhën e 3 (tre) viteve të fundit;
- i- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- j- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 23.04.2026, në adresën: Zyra e Arkiv-Protokollit, "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", Njësia Administrative nr. 4, Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni "Skënderbej" Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Jo më vonë se data **03.05.2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "Agjencia Kombëtar e Punësimit dhe Aftësive" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohen intervistat.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni, nëpërmjet adresës e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia e burimeve njerëzore pranë Autoritetit mbi Informimin mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

I. Njohuritë mbi:

- a) Ligji nr.76/2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- b) Ligjin Nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”*;
- c) Rregulloren e Brendshme të Autoritetit mbi Informimin mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit.
- d) Ligjin Nr. 152/2013, *“Për Nëpunësin Civil”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dale në zbatim të tij;
- e) Ligjin Nr. 8480, date 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*, i ndryshuar;
- f) Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- g) Ligjin Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*;
- h) Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 *“Për Arkivat”*, i ndryshuar;
- i) Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar.
- j) Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar.
- k) Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*;
- l) Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*;
- m) Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.
- n) Ligjin Nr. 10/2023 *“Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”*
- o) Ligjin Nr.162/2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim;
- p) Ligjin Nr. 7514, datë 30.9.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, i ndryshuar;
- q) Ligjin Nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshtëpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”* i ndryshuar;

II. Aftësitë për të:

- Menaxhuar situatë emergjente;
- Menaxhuar situatë të cilat nuk kanë qënë të parashikuara;
- Marrë vendime mbi bazën e argumentave;
- Shprehur opinion dhe argumenta në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme;
- Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionet e tyre;
- Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme;
- Komunikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave;
- Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe material me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur proçesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 10 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen nepermjet nje testimi me shkrim ne lidhje me:

- a- Kuptimin e gjërë të komptencave ndërsektorale në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës dhe institucioneve të tjera të administrës publike;
- b- Njohuritë mbi legjislacionin vendas dhe nderkombetar në lidhje me pozicionin e punës;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- c- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- d- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- e- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 50 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 6, datë 19.9.2014, “*Për procesin e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve civilë të lartë drejtues, anëtarë të TND-së*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.2, datë 2.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike <https://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime/udhezim-nr2-date-27032015/>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtar e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.